



FUSHATA NDERKOMBETARE “HEFORSHE”!

Newsletter nr 8, 2 Nëntor 2015

Përmbledhje

Në kuadër të fushatës “Mobile campaign Boys and Men for Gender Equality”



Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, një nismë e UNICEF Shqipëri, është një entitet i shoqërisë civile shqiptare që ka në fokus mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve. Si pjesë aktive dhe integrale e shoqërisë civile në çdo rajon, Observatori bashkëpunon me aktorë publikë dhe privatë në procesin e mbledhjes sistematike të të dhënave dhe

nxjerrjen e raporteve në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve, zbatimin e ligjeve në këtë fushë dhe identifikimin e nevojave për përmirësime.

Observatori ka zbatuar disa nisma në mbështetje të barazisë gjinore dhe dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri.

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve, një nismë e UNICEF Shqipëri, ka zhvilluar një mekanizëm që lejon mbledhjen e informacionit dhe nivel rajoni (Qarku) në lidhje me situatën dhe të drejtat e fëmijëve.

Si pjesë aktive dhe integrale e shoqërisë civile në çdo rajon, Observatori bashkëpunon me aktorë publikë dhe privatë në procesin e mbledhjes sistematike të të dhënave dhe nxjerrjen e raporteve dhe relacioneve informuese në lidhje me të drejtat e fëmijëve, zbatimin e ligjeve në këtë fushë dhe identifikimin e nevojave për përmirësime.

thenja nga UNWomen

Së fundmi Observatori u angazhua vullnetarisht në lëvizjen solidarë HeforShe. Kjo lëvizje ndërkombëtare për

barazi gjinore synoi të mobilizojë burrat dhe djemtë, vendimëmarrës, aktivist , përfaqësuesit të pushtetit lokal dhe vendor , të angazhohen për ti dhënë fund diskriminimit dhe pabarazisë kundër grave dhe vajzave në Shqipëri.

Gjatë procesit të realizimit të video HeforShe, u bë e mundur sensibilizimi i një numri të konsiderueshëm të djemve dhe burrave në cdo qark. Shumë prej tyre u angazhuan në përcjelljen e mesazheve kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri.

Pjesë e rëndësishme e fushatës ishte angazhimi i Zv kryeministrit Z.Niko Peleshi, Kryetarit të bashkisë Korçë Z. Sotiraq Filo, Prefektiti të Qytetit të Korçës Z.Ardit Konomi , Drejtore të Drejtorive në nivel lokal, Përfaqësues të pushtetit lokal, të rinj aktivist, etj

Në kuadër të angazhimit të Observatorit në lëvizjen HeforShe u bë e mundur sensibilizimi i 120 personave të ndryshëm në 12 qarqe të Shqipërisë duke realizuar në total 41 video HeforShe.

Nga paraqitje grafike në hartë vihet re që disa qytete nuk kanë realizuar asnjë video. Pavarësisht personave të kontaktuar dhe këmbënguljes së stafit, individët janë shmangur me pretekstin “nuk kam kohë”, “nuk mundem”.Ky rezultat jo fort i dëshiruar le të kuptojmë që në disa zona është e nevojshme të realizohen më shumë fushta ndërgjegjësuese dhe takime me djem dhe burra në mënyrë që ato të angazhohen me lehtësiht në përcjelljen e mesazheve kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri.

Thënje të shkëputura nga video të realizuara në Qarqe

Zëvendës Kryeministër, Z. Niko Peleshi - “ betejën për një shoqëri të barabartë mes burrave dhe grave, djemve dhe vajzave nuk e kemi fituar ende. Ndaj është e drejta e grave dhe vajzave dhe detyra e burrave dhe djemve, të luftojnë për një shoqëri të barabartë, me shance të barabarta.

Kryetar i Këshillit Rinor Kukës, Z. Rubin Omuri- “ I drejtohem të gjithë burrave dhe djemve kuksian, t’i përkrahin nënat e motrat tona e t’i japin atyre atë që ju takon ; të drejta të barabarta...”

“ së pari barazia gjinore nis pikërisht nga ne, djemtë dhe burrat për t’i mundësuar të drejta të drejta të barabarta grave dhe vajzave”- Erti Bejdo

